UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I MJEKËSISË
PRISHTINË
Pranuar më: 23.09.2024
9117

Universiteti i Prishtinës
"Hasan Prishtina"
*UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS*
Fakulteti i Mjekësisë
**Bulevardi i Dëshmorëve p.n, 10000 Prishtinë, Kosovë**
Tel: +381-38-512221 URL: http://www.uni-pr.edu
Fax: +381-38-512223 Mail: mjekesia@uni-pr.edu

**1. Ref. nr. Prishtinë, 20.09.2024**

Raport i Komisionit për shqyrtimin e ankesave të parashtruara për raportet e Komisioneve Recensuese të publikuara në buletinet për procedurat e përzgjedhjes lidhur me angazhimin e bashkëpunëtoreve të jashtëm për ligjerata dhe ushtrime për vitin akademik 2024/25, në konkursin e shpallur nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" me nr.2/3426, të datës 25.07.2024

Në bazë të vendimit të Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë me numër 6615 të datës 28.08.2024 është emëruar Komisioni për shqyrtimin e ankesave të parashtruara lidhur me raportet e Komisioneve Recensuese për procedurat e përzgjedhjes lidhur me angazhimin e bashkëpunëtoreve të jashtëm për ligjerata dhe ushtrime për vitin akademik 2024/25, në përbërje:

1. Prof. Ass. Dr. Astrit Hamza - Kryetar
2. Prof. Ass. Dr. Aida Loshaj – Anëtare
3. Ass. Dr. Nora Aliu –Anëtare

Me datën 20.09.2024 në ora 09:00 komisioni për shqyrtimin e ankesave ka filluar shqyrtimin e dokumentacionit të kandidatëve të cilët kanë parashtruar ankesa, duke u bazuar ne Statutin e UP-se, Rregulloren me nr. 2/254 te UP-se të datës 17.07.2024 për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës.

Pas vlerësimit të numrit të ankesave të deponuara, komisioni për shqyrtimin e ankesave konstaton se 2 kandidatë kanë parashtruar ankesën e tyre, dhe të njejtit janë paraqitur me radhitje si në vijim:

1. **Veton Fetahaj- pozita 1**
2. **Halil Asllani-pozita 1**

**1. Veton Fetahaj- pozita 1, ka parashtruar ankesë:**

1.1 Kandidati ankesen e bazon në faktin se komisioni vlerësues nuk ka marre parasysh pervojen e tije ne mesimdhënje te së njejtes lënde të cilen e ka mbajtur vite me radhe kundrejt kandidates se propozuar, si dhe vleresimin pozitiv të studenteve.

Komisioni i ankesave pas analizimit te dosjeve të kandidatëve (ankuesit dhe të propozuares), gjen se ankuesi nuk i ka të perfunduar studimet e doktorates. Nderkaq kandidatja e propozuar ka PhD dhe ka pervoje ne mesimdhenje në IAL.

Nga sa u tha me lart, **komisioni për ankesa konstaton se ankesa eshtë e pa bazuar.**

**2. Halil Asllani-pozita 1, ka parashtruar ankesë:**

2.1 Kandidati ankesen e bazon në faktin se komisioni vlerësues në vlerësimin perfundimtar duke propozuar kandidaten Festime Mehdiu-Gashi, ka publikuar te dhena te mangeta dhe nuk ka arsyetuar pse kandidatja e perzgjedhur i ploteson kushtet me se miri? Po ashtu ankuesi pretendon se kunderkandidatja nuk ka PhD specifike per poziten e konkursit qe kerkohet. Komisioni i ankesave pas analizimit te dosjes të kandidatës të apostrofuar më lartë si të propozuar dhe pretendimeve të ankuesit konstaton se kandidatja e propozuar ka PhD e njejte me ankuesin, dhe po ashtu gjitha pretendimet tjera te ankuesit i gjen te pabazuar.

Nga sa u tha me lart, k**omisioni për ankesa konstaton se ankesa është e pabazuar**

Komisioni për shqyrtimin e ankesave:

Prof. Ass. Dr. Astrit Hamza – kryetar

Prof. Ass. Dr. Aida Loshaj– anëtar

Ass. Dr. Nora Aliu - anëtare